



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




TE 7
Berat Buzhala
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/287- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TE 7 (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
2. KPM me datën 9 shtator 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Qëllimi i dërgimit të Udhëzuesit ka qenë që të licencuarve t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2021.
3. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së ka bërë monitorimin e këtij ofruesi të shërbimeve mediale. Bazuar në Raportin e monitorimit të datës 23 shtator 2021 KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 23 shtator 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse shkresë, me të cilën e ka njoftuar për të gjeturat dhe e ka udhëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
5. KPM prej datës 20 deri me 27 shtator 2021 ka bërë monitorim të vazhdueshëm dhe bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse, ka transmetuar pika reklamuese politike të cilat janë identifikuar si hapësira të sponsorizuara me pagesë dhe pa pagesë, por nuk janë identifikuar organizatat ose individët përgjegjës për to, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073.



6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 28 shtator 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse shkresë, me të cilën e ka njoftuar për të gjeturat dhe e ka udhëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073.
7. KPM pas dërgimit të shkresave ka bërë edhe një monitorim të Palës përgjegjëse për të vlerësuar ardhjen në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 4 tetor 2021 është gjetur se Pala përgjegjëse vazhdon të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073.
8. KPM, për të vlerësuar ardhjen në pajtueshmëri të Palës përgjegjëse me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073, si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së në mënyrë të vazhdueshme ka bërë monitorimin e këtij ofruesi të shërbimeve mediale. Bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 tetor 2021, KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka vazhduar duke i përsëritur shkeljet e njëjta sa i përket Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15 si dhe me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073. Po ashtu, në këtë Raport monitorimi ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9 paragrafi 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave, bazuar në analizat dhe faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 dhe nenin 9 paragrafi 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
10. KPM konstaton se Pala përgjegjëse është njoftuar me kohë për respektimin të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje, Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, i është dërguar Udhëzuesi me qëllim që t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore, mirëpo sërish është gjetur në shkelje. Bazuar në Raportet e monitorimit është gjetur se Pala përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore në emisionin "Pressing" dhe "DPT" ka pasur reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se:

"Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë."

11. KPM, po ashtu ka konstatuar se emisionet "Pressing" dhe "DPT", të cilat trajtojnë çështje aktuale politike, sociale, ekonomike dhe zhvillimet e fundit në vend, janë sponsorizuar,

duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 3 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se:

“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen.”

12. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse në emisionet “Pressing” dhe “DPT” ka bërë edhe vendosje të produkteve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.
13. KPM bazuar në Raportin e monitorimit, ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore ka transmetuar pika reklamuese politike të cilat janë identifikuar si hapësira të sponsorizuara me pagesë dhe pa pagesë, por nuk janë identifikuar organizatat ose individët, se nga kush janë të paguara apo të sponsorizuara, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin “përgjegjës për të.”

14. KPM konstaton se Pala përgjegjëse nuk i ka marrë për bazë shkresat për të ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, dhe nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073, duke vazhduar t’i bëjë shkeljet e njëjta në emisionet Pressing” dhe “DPT”. Gjatë këtyre emisioneve janë transmetuar reklama në ekran të ndarë, është bërë vendosje e produkteve si dhe janë sponsorizuar. Po ashtu, ka vazhduar duke transmetuar pika reklamuese politike të cilat janë identifikuar si hapësira të sponsorizuara me pagesë dhe pa pagesë, por nuk janë identifikuar organizatat ose individët, se nga kush janë të paguara apo të sponsorizuara.
15. KPM bazuar në Raportin e fundit të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore ka transmetuar një pikë reklamuese politike e cila është e identifikuar si hapësirë e sponsorizuar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në të cilën shihet prezenca e fëmijëve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 7, Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike”


16. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 tetor 2021 ka konstatuar se Pala përgjegjëse sa i përket shkeljes së Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, dhe të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073 është duke vazhduar t’i bëjë shkeljet e njëjta. Po ashtu, ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka transmetuar spot politik në të cilën shihet prezenca e fëmijëve, duke bërë shkelje të nenit 9 paragrafi 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
17. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 12 paragrafi 1, nenit 14 paragrafi 3 dhe nenit 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, si dhe nenit 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073 dhe të nenit 9 paragrafi 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

18. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej dymijë (2,000) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 12 paragrafi 1, nenin 14, paragrafi 3 dhe nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, nenit 9 paragrafi 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, dhe nenit 49 paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073.

E drejta për ankesë

19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat Latifi
Kryetar



18.10.2021
Datë